

Syllabusi i lëndës

Lënda: Objektivat e të Drejtës Islame

Programi i studimit: Studime Islame

Numri i ECTS kredive: 4

Statusi i lëndës: Obligative

Kodi i lëndës: 412

Fondi i orëve: 2+0

Viti akademik: 2026-2027

Semestri: VIII

Mësimdhënësi: Dr. Violeta Smajlaj

Përshkrim i shkurtër i lëndës

Kjo lëndë do të japë një pasqyrë hyrëse mbi Objektivat e Sheriatit, që nga origjina e idesë dhe zhvillimi teorik i saj, deri te realiteti i sotshëm i pavarimit të kësaj lëmie si shkencë në vete, e ndarë nga Usuli. Gjithashtu, do të paraqesë një pamje gjithëpërfshirëse të rëndësisë së mendimit në bazë të një qëllimsie metodike për të racionalizuar ixhtihadin bashkëkohor dhe për të zvogëluar rrethin e mosmarrëveshjeve mes studiuesve të së drejtës islame në çështje të pjesshme të fikhut. Lënda hedh dritë mbi fazat historike të qëllimsisë së Sheriatit dhe hulumton ndikimin e zhvillimeve intelektuale, sociale dhe politike të popujve muslimanë në zhvillimin e kësaj lëmie. Do të mësohet për teorinë, praktikën, historinë dhe figurat udhëheqëse në këtë fushë, si dhe për metodat e zbulimit të objektivave, duke hetuar mundësinë e përfitimit nga metodat e hulumtimit në shkencat shoqërore bashkëkohore për zbulimin e objektivave dhe verifikimin e përmbushjes së tyre. Do të shqyrtohen tematikat më kryesore të shkencës El-Mekasid, që nga origjina e idesë së qëllimsisë juridike deri te roli i objektivave në fetvatë bashkëkohore dhe sfidat e kësaj fryme të re të së drejtës në botën moderne. Temat në këtë lëndë përfshijnë definicione, metoda zbulimi dhe procese të zhvillimit të objektivave të sheriatit, që nga paraqitja e idesë deri në ditët e sotme, si dhe raportin e kësaj lëmie me shkencat tjera duke trajtuar ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet tyre, e në veçanti fokusohemi në raportin e qëllimit me mjetet për nga ndryshueshmëria.

Qëllimi i lëndës

- Pajisja e studentëve me njohuri bazë mbi qëllimet e sheriatit. Studenti do të hulumtojë konceptin, zanafillën dhe etapat e zhvillimit, strukturën e saj, raportin që mbanë me shkencat tjera dhe me botëkuptimet e ndryshme që përngjajnë me të.
- Zhvillimi i shkathtësive për të analizuar arsyet e interesimit të shtuar për objektivat e sheriatit në mendimin bashkëkohor islam.

- Avancimi i sensit kritik në aspektin e vlerësimit të argumenteve bazuar në fakte përkatëse nga burimet islame. Për shkak se zhvillimi i mendimit juridik është një çështje e pandalshme, kërkon vëmendjen e secilit brez për të arritur njohuri sa më të shëndosha.
- Aftësimi për të shkruar ese apo për të diskutuar për tema të ndryshme nga lëmi i Fikhut dhe Usulit në një stil të pastër arsyetimi, bindës në të shprehur dhe me shkrim.
- Njohja e studentit me metodat e zbulimit të objektivave të sheriatit dhe lidhjen e tyre me metodat e hulumtimit në shkencat shoqërore bashkëkohor, si dhe njohja me mënyrat e verifikimit sa janë realizuar objektivat.
- Njohja e rëndësisë së objektivave të sheriatit në mendimin bashkëkohor të ixhtihadit.
- Analizimi dhe kritikimi i marrëdhënies së qëllimit me mjetet e tij për sa i përket qëndrueshmërisë dhe ndryshimit.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të kursit, studentët do të jenë në gjendje të:

- Demonstrojnë një kuptim të temave kryesore të Objektivave të Sheriatit;
- Përshkruajnë proceset e zhvillimit, metodat e zbulimit të objektivave dhe perspektivat;
- Identifikojnë karakteristikat e lëmisë, figurat e shquara dhe personalitetet, si dhe ndikimin që ka lëmia në disiplina të tjera.
- Krahasojnë ndërmjet mendimeve të ndryshme të cilat i studiojnë gjatë kursit.
- Diskutojnë rreth tematikave të lëmisë në bazë të argumenteve të tyre, duke arritur në konkluzione sa më të qarta dhe objektive.
- Mbrojnë qëndrimet e qëllimsisë sheriatike, ashtu siç i konceptuan themeluesit.
- Parashtrajnë mendimin kritik ndaj secilës temë të debatuar prej dijetarëve të fushës, duke përfunduar në konkluzime me argumente më të shëndosha.
- Aplikojnë njohuritë e fituara në relacionin e tyre fetar dhe ndërshoqërorë.

Metodologjia e mësimdhënies:

Mësimi do të zhvillohet në formë të ligjëratave, me anë të projektorit, i cili i ndihmon studentët që ta kuptojnë edhe më qartë ligjëratën, stimulimit të tyre në diskutime interaktive, duke bërë pyetje dhe analiza në kuadër të ligjëratës së mbajtur. Po ashtu do të mbahen seminare dhe ese të ndryshme, të cilat do të prezantohen në mënyrë individuale por edhe grupore, dhe teste të vetëvlerësimit. Gjithashtu studentët kanë mundësi që gjatë përgatitjes së lëndës të kontaktojnë me profesorin dhe të marrin udhëzime me qëllim të arritjes së cilësisë dhe rezultateve sa më të mira.

Përmbajtja e lëndës:

Java e parë: Prezantimi i lëndës, Hyrje, Njohja me syllabusin, metoda, organizimi dhe shqyrtime të përgjithshme: *Qëllimsia si dukuri mbarë njerëzore, e jo vetëm hyjnore.*

Java e dytë: Ç'nënkuptojnë “objektivat e sheriatit”? A dallon ky term nga të ngjashmit?

Bisedë interaktive, duke krahasuar këto koncepte njëri me tjetrin.

Literatura: Dispenca nga proferoresha (f.1-4); Ahmed Er-Rejsuni, *Objektivat e ligjit islam*, (f. 25-45).

Valon Myrta, *Hyrje konceptuale në qëllimet e Sheriatit*, Buletini.

Java e tretë: Zhvillimi historik i objektivave të sheriatit: nocioni para Shatibiut.

Diskutim rreth nevojës për objektivat e sheriatit.

Literatura: Ahmed Er-Rejsuni, *Objektivat e ligjit islam*, (f. 49-98)

Xhasir Avde, *Intencat e Sheriatit si filozofi e së drejtës islame*, (f. 30-63).

Java e katërt: Tematika dhe baza e Objektivave të së drejtës, dallimi mes objektivave të së drejtës dhe objektivave të përgjegjësve, (Dispenca nga profesoresha (f. 8-10)

Java e pestë: Origjina dhe literatura: Fillet e shkencës Objektivat e të drejtës, ku gjinden dhe veprat më të shquara

Literatura: Dispenca nga profesoresha (f. 16-19).

Java e gjashtë: Kategorizimi i objektivave.

Literatura: Dispenca nga profesoresha: (f. 22-28);

A. Er-Rejsuni, *Objektivat e ligjit islam*, (f. 193-228).

Java e shtatë: Mënyrat e zbulimit të objektivave të sheriatit.

Debat: përfitimi nga metodat e hulumtimit në shkencat shoqërore.

Literatura: A. Er-Rejsuni, *Objektivat e ligjit islam*, (f.228-230&409-428),
Dispenca nga profesoresha (21-22)

Java e tetë: Identifikimi i interesave nepërmjet arsyes njerëzore. Reflektime dhe ushtrime për mësimet e deritanishme: shembuj të objektivave, ofrohen ajete Kuranore dhe hadithe për të nxjerrë objektivat duke përcaktuar llojet e tyre.

Literatura: A. Er-Rejsuni, *Objektivat e ligjit islam*, (f. 353-408).

Java e nëntë: Normat e përgjithshme të objektivave të së drejtës

Literatura: *Dispenca e profesoreshes*, (f. 29-32).

Java e dhjetë: Llojet e vështirësive dhe qartësimi i atyre me të cilat lidhet teklifi

Literatura: *Dispenca e profes*, (f. 33-39).

Java e njëmbëdhjetë: Mjetet e ruajtjes së objektivave (nga ana e ekzistences dhe asgjësimit

Literatura: Dispenca nga profja (f. 40)

Java e dymbëdhjetë: Objektivat e të drejtës islame: Ruajtja e të drejtave të njeriut; Relacioni i qëllimit me mjetet e tij: qëndrueshmëria dhe ndryshimi.

Reflektime dhe Përsëritje nga orët e mëparshme.

Java e trembëdhjetë: Marrëdhënia e objektivave me argumentet

Literatura: Dispenca e profesoreshes (f.42-47)

Java e katërbëdhjetë: Ndërlidhshmëria e objektivave të sheriatit me lëmitë islame.

Shqyrtimi i punimeve seminarike.

Literatura: Valon Myrta, Punim i pabotuar.

Java e pesëmbëdhjetë: Realiteti i Ixhtihadit në zbatimin e objektivave

Përkufizimi i ihtihadit në zbatimin e objektivave, Kriteret për zbatimin e objektivave të shoqëruara me shembuj në secilin lloj të objektivave bazike

Literatura: Dispenca e profesoreshës (f. 48-51); A. Er-Rejsuni, *Objektivat e ligjit islam*, (f. 487-504);

Java e gjashtëmbëdhjetë: Dobitë e zbatimit të objektivave në Jurisprudencë dhe

Aplikimi në disa degë të jurisprudences dhe çështjeve bashkëkohore, shembuj të ndërtimit të hukmit në sajë të Objektivave, Reflektime dhe Përmbyllje

Literatura: Dispenca e profesoreshës (f. 51-52);

Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjeratë 10%

Punimi seminarik 20%

Testi intermedier 30%

Provimi final 40%

Total 100%

Literatura obliguese:

1. Dispencë nga profesoresha
2. Ahmed Er-Rejsuni, *Objektivat e ligjit islam*. Bujar Hoxha (përkth.), Shkup: Logos-A, 2015.
3. Xhasir Avde, *Intencat e Sheriatit si filozofi e së drejtës islame*. Shaban Sulejmani (përkth.), Shkup, 2015.
4. Valon Myrta, *Hyrje konceptuale në qëllimet e Sheriatit*, Buletini.

Literatura konsultative:

1. Esh-Shatibi. *El-Muvafekatë*. Abdullah Deraz (red.), Beirut: Darul-kutubil-ilmijje.
2. Muhamedtahir bin Ashurë. *Mekasidush-Sheria*. Muhamed El Misavi (redakt.).
3. Ismail El Haseni. *Nadharijetul Mekasid inde Muhamedtahir bin Ashurë*. Washington: El Ma'hedul Alemi lil fikril Islami, b.1, 1995.
4. Numan Xhugajm, *El-Muharrer fi mekasidish-sheria*, Amman: Darun-nefais, 2019.